


KOMUNA E SHITES



DREJTORIA E PROKURIMIT
KONTRATE PER SHERBIM

LOTI -I-

Numri i kontrates: 617-24-8833-2-2-1/C759/1
Komuna Shtime Rr., Tahir Sinani, tel. 0290-389-016-228 qe e perfaqeson Muhadin Halili,
Udhheqes i Zyres se Prokurimit ne njeren ane:

dhe
AUTOTRANSPORTUES MURAT HAZIRI, Rr. Milaim Beha, SHTIME, 600852158, qe e perfaqeson
Murat Haziri, nr i tel. 044-790-008, Ofruesi i Sherbimeve ne anen tjeter, jane pajtuar te
lidhin nje kontrate publike per sherbimet e shenuara me poshte:

Transporti i nxenesve per shkollat e Komunes se Shtimes

Me numer identifikues: 617-24-8833-2-2-1

Neni 1 Lenda

1.1 Lenda e kontrates eshte performimi i sherbimeve ne vijim nga ana e Ofruesit te Sherbimeve:
TRANSPORTI I NXENESVE NE RELACIONIN LUZHAK-REÇAK

Neni 2 Qmimi

2.1 Qmimi total i sherbimeve duhet te jete: 5,069.00 € (pesë/zero/gjashtë/nëntë/zero/zero)
2.2 Qmimi i permundur ne Nenin 2.1 me sipër duhet te jete e vetmja pagesë qe Autoriteti Kontraktues i ka
borxh Ofruesit te Sherbimeve sipas kontrates. Ai duhet te jete i prete dhe te mos i nenshtrohet ndryshimeve.
2.3 Pagesat do te behen ne pajtim me Kushtet e pergjithshme dhe/ose te Veganta te kontrates.

Neni 3 Rendi i perparesisë i dokumenteve te kontrates

3.1 Kontrata perbehet nga dokumentet ne vijim:

- (a) Marteveshja e kontrates; PO
- (b) Kushtet e Veganta te Kontrates; PO
- (c) Kushtet e Pergjithshme te Kontrates; PO
- (d) Tenderi i Ofruesit te Sherbimeve,
- (e) Oferta financiare (Pershkrimi i Qmimeve); PO

3.2 Dokumentet e ndryshme qe e perbejne kontraten konsiderohet se shpjegojne njera tjeter; dhe ne raste te
pagartesise ose divergjences, ato duhet te lexohen sipas rendit te perparesisë ne te cillin jane dhene me sipër.

Neni 4 Komunikimet



4.1 Te gjitha komunikimet me shkrim qe kane te bejne me kete Kontrate ndermjet Autoritetit Kontraktues, nga
njera ane dhe Ofruesit te Sherbimeve nga ana tjeter duhet te cekin titullin e Kontrates dhe numrin e saj te
identifikimit dhe duhet te dergohen me poste, faks, email ose te dorzohen personalisht.
4.2 Nese personi qe dergon komunikaten kerkon vertetim te pranimi te saj, ai duhet ta thote kete ne
komunikaten e tij. Sa here qe ka arafat te fundit per pranimin e komunikates me shkrim, derguesi duhet te

kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënieën e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikatë, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj", "ose"vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën 3 në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Udhëheqës i Zyres së Prokurimit
Nëshkrimi:	
Data:	19.09.2024
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Murat Haziri
Pozita:	Pronar
Nëshkrimi:	
Data:	19.09.2024
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITTHSHMIE

Numri i kontratës: 617-24-8833-2-2-1/C759/1

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, sig është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e korporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përkufizimet të Përfshira në Tënderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë qdo person fizik, privat ose subjekt i geverisë, ose kombimimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejues, për të cilin qdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutohet në tërësi nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, sig mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, sig specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veganta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha gëshjet që nuk janë të mbuluar në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të ciles Ofruesi i Shërbimeve e transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kryeruar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkaruar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kryeruar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkaruar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimin i një transferimi nga Autoriteti Kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së ciles Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkuptohen dhe identiteti i nënkuptuesve i bëhen të ditura

Autoriteti kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes, Ne rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmëtoj Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i parqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmitëse.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovim i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatumet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrimet të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të nëvoneshme sipas mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, sig është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

6.5 Vendi i kryes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjë tën nga këto arsye:

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) forca madhore sig është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kapitur se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejof Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit sipas mund të arsyerohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkakuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien e kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbyllyjet e objekteve ose grëqullimet tjera industriale, vepimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruar ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rreshtqitjet e tokës, tëmte, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e pabarashkueshme që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballlohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar pafatesinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështrimin për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultuar i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështrimit për të kryer obligimet e tij është rezultuar i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do të lajmëtojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërsa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatohet mjetet e tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 8 Forca madhore

Neni 9 Ndërpjerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë parafajmërim, ta ndërprejë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dëshon në përmbushjen benda një afati të arsyeshëm të parafajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështrim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur, punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato gëshqije, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapartë në legjislationin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është denuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cillin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshijë në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në shtesën e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin e kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurtimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurtimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërpjerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësi të tjera të autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshtrohet ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërrprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërrarë hapë të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për të zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërrprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet të i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërrprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstër, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet të i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërrprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërrpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkakuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërrperja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka parafunduar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërrpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues,

- a. nuk arin të i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
 - b. vazhdimisht nuk arin të i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura, ose c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafat të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej 90 ditësh të pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- 10.2 Ndërrperja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.
- 10.3 Në rast të ndërrprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund të jetë shkakuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas udhrrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse ai, duke iu ekspozuar dënimt për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i parqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet të i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personelli i tij, të afërmit e tyre, dhe puntorët vendorë të tij gjithashtu të i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet të i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar të i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përberja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyq të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësues nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë qdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbësisht të barabarta ose më të mira se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumentete të tilla do t'i këqehen Autoriteti Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërktoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatuar pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti Kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikjet, dhe për mbulim, sig do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në logarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në logarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda 10 më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të behet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbërthe që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pike të përbimjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).
16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Partimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigjohet.
18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit kontraktues, Autoriteti kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguajë këtë shumë, dhe do pasojë një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes së kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shijojë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.
19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për keto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
 - b) ndërprerjen e kontratës.
- 19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:
- a) Dëme të përgjithshme; ose
 - b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbujimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shtaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shpreh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpigjen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykatata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtarët e tij dhe ish zyrtarët, drejtorët, punonjësit dhe agjentët e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëm, dhe pagesat e shaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqërdorimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësive intelektuale të asaj palë të tretë.

KUSHJET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-24-8833-2-2-1/C759/1

KVK në vijim do të plotësojë dhe/ose ndryshojë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


Kushlet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nentit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nentit	Nr. Nentit		
Ligji i zbatueshëm dhe gjyha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha gëshjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.	
Përfundimi dhe shërbimeve	2.2	Gjyha e përdorur do të jetë Shqipe	
	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 19.09.2024	
	6.4	Data e Përfundimit është 30.06.2025	
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : <i>Shkolla e Jshaiti Regak</i>	
	12.3	Menaxheri i Projektit emrohet nga ZKA	
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të gëmit final të kontratës.	
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	14.1	Për humbje ose dëmtim të implantëve dhe Materialeve 1. humbje ose dëmtim i Pajisjeve 2. humbje ose dëmtim i pronës 3. dëmtim personal ose vdekje (i) të punëtorëve të Kontraktuesit (ii) të personave të tjerë Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)	
Parimet e Përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: OE, duhet të sjellë fakturën e rregullt. Në faturë duhet të figuronjë: Emri i projektit, nr. i kontratës si dhe nr. i urdhërblenës, fatura duhet të jetë e protokolluar, raporti i menaxherit të kontratës për shërbimet e kryera, pasafaj bëhet pagesa	
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje eventuale, në mes OE dhe AK, do të zgjidhet me negociata (Marrëveshje)	
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatë në pajtim me ligjin në Kosovë.	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA: TRANSPORTI I NXËNSËVE NE RELACIONIN LUZHAK-REGAK

LOTTI - 1

NR	PËRSHKRIMI	NJESIA	MATËSE	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
1	Transporti i nxënësve, relacioni Luzhak-Regak dhe anasjelltas, bartja bëhet në dy drejtime.	Diç		185	27.40 €	5,069.00 €
Totali:						5,069.00 €

Emri i Kompanisë	KOMBI TAXI MURAT HAZIRI
Adresa e Pote	Rr. Millaim Beha Shtime
Përqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	
Pozita	Murat Haziri
Nëshkrimi	<i>Murat</i>
Data	06.09.2024
Vula	





Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
 Uprava za Urbanizam, Katastar i Gjeodeziju
 Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy

Data/Datum/Date:	18.09.2024
Nr./Br./No	06/135
Per/Za/For:	Drejtorinë e Prokurimit
Ngj./Od./From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
Linda/Predmet/Subject :	Vendim, për Menaxher të Kontratës dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pikë g), si dhe nenit 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2021, dhe Vendimit të ZKA nr. 02/70, të datës 25.03.2022 për autorizim për emërimin e menaxherëve dhe mbikëqyrësve të kontratave. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi merr këtë:

VENDIM

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: "TRANSPORTI I NXËNSËVE NE RELACIONIN LUZHAK-REÇAK-LOTI - I"
2. Menaxher i Kontratës: **z. Idriz Mehmeti**
3. Emërohet Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: **Yllka Fejzullahu-Drejtoresh e Arsimit**
4. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe Manualët për përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
 Tu dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyres së Kryetarit;
4. Drejtorisë së Prokurimit.